





**Agjencia për Menaxhimin e
Komplekseve Memoriale të Kosovës**



Komuna Vushtrri

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

**PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT – “NDËRTIMI I SHEHSHIT AHMET KRASNIQI NË
VUSHTRRI”**

Palët Nënshkruese,

1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, përfaqësuar nga **z. Bislim Zogaj**, Drejtori i Agjencisë
dhe
2. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga **z. Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i projektit “Ndërtimi i Sheshit Ahmet Krasniqi në Vushtrri” dhe përcaktimi i obligimeve të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Komunës së Vushtrrisë për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 Vlera e projektit

Projekti ka vlerë parallogaritare në shumë prej 157,302.00 €, prej të cilave,
- AMKMK i siguron 60,000 00 € për punimin e Shtatores së Kol. Ahmet Krasniqi, ndërsa
- Komuna i siguron 97,302.97 € për rregullimin e bazamentit të shtatores dhe sheshit.

Neni 3

Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

3.1 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës merr përsipër që për projektin - punimit i shtatores, të zbatoj procedurat e prokurimit konform ligjit në fuqi për prokurimin publik.

3.2 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës cakton menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik të shtatores.

3.3 Menaxheri i projektit, organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

3.4 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që projekti të përfundoj gjatë vitit buxhetor 2019. Në rast se gjatë këtij viti nuk kryhet shtatorja, të gjitha obligimet për përfundimin e shtatores mbesin në përgjegjësi të Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

3.5 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës do ta njoftoj Komunën për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani një mujor deri në përfundimin e projektit. Po sa te përfundoj shtatorja nëse komuna nuk e ka të ndërtuar bazamentin ku do të vendoset shtatorja, atëherë AMKMK ja dorëzon shtatoren komunës dhe përgjegjësinë për ruajtjen në një vend të caktuar deri në vendosje e merr komuna e Vushtrrisë.

Neni 4

Obligimet e Komunës

4.1 Komuna është e obliguar që të siguroj projektin zbatues dhe dokumentacionin e nevojshëm për projektin - ndërtimi i bazamentit të shtatores dhe sheshit sipas projektit, si dhe zbatoj procedurat e prokurimit publik konform Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.

4.2 Komuna e Vushtrrisë do të caktoj organin mbikëqyrës profesional për përcjellje të realizimit të projektit nga kjo marrëveshje.

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

5.1 Me pëlqimin paraprak të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe Kryetarit të Komunës, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

5.2 Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se komuna nuk i përmbushë obligimet e veta nga kjo marrëveshje.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim të ndërsjellë.

Neni 7
Pronësia e projektit

7.1 Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik ky projekt nga kjo marrëveshje për sa i përket punimit të shtatores, do të kaloj me automatizëm në pronësi të Komunës së Vushtrrisë.

7.2 Ky projekt regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë fizike dhe elektronike në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

Neni 8
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër ekzemplarë, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që marrëveshje e mirëkuptimit të hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

AMKMK


Bislim Zogaj, Drejtor



Komuna Vushtri

Xhafer Tahiri, Kryetar